



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2019:240416

Datë: 31.01.2025

Numri i dokumentit: 06783679

KE.nr. 380/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Arbër Rexha, në çështjen juridike të Paditësit N.N. “Shqipëroni”, me numër unik identifikues 81030866 dhe seli në Malishevë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Xhevdet Krasniqi, avokat nga Prishtina, kundër të Paditurës Komuna e Prizrenit, me objekt kontesti rimbursimi i diferencës së TVSH-së, vlera e objektit të kontestit EUR 7,887.34, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor publik të datës 23.01.2025, në prezencë të përfaqësuesit të autorizuar të Paditësit, e në mungesë të të Paditurës, me datë 31.01.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e Paditësit N.N. “Shqipëroni”, me seli në Malishevë, dhe DETYROHET e Paditura Komuna e Prizrenit, që në emër të diferencës së tatimit mbi vlerën e shtuar nga norma e interesit 16% në normën e interesit 18%, sipas kontratës me numër 622-14-152-521 të datës 11.03.2015, t’ia paguaj Paditësit shumën prej EUR 7,887.34, (shtatë mijë e tetëqind e tetëdhjetë e shtatë Euro e tridhjetë e katër Cent), me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, data 23.07.2019, e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- II. DETYROHET e Paditura Komuna e Prizrenit, që Paditësit N.N. “Shqipëroni”, t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën e përgjithshme prej EUR 674.40 (gjashtëqind e shtatëdhjetë e katër Euro e dyzet Cent), në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve ndërgjyqëse:

Paditësi N.N “Shqipëroni”, me seli në Malishevë, përmes përfaqësueses së autorizuar me datë 23.07.2019, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi ndaj të paditurës Komuna e Prizrenit, me seli në Prizren, për pagesën e diferencës së tatimit mbi vlerën e shtuar.

Ndër të tjera, paditësi në padi ka theksuar se me datë 11.03.2015, ka nënshkruar kontratë me të paditurën për ndërtimin e objektit të ri shkollor (9 klasa) “Ekrem Rexha” në Gërnqarë të Prizrenit, ashtu që janë dakorduar që çmimi total i punimeve të jetë në shumë prej EUR 394,637.00. Ndërsa, ka shtuar se mes palëve nuk është kontestuese se punët janë kryer sikurse nuk është kontestues as çmimi i kontratës, mirëpo kontestuese është diferenca e lartësisë së TVSh-së, pasi që sipas nenit 26, pika 1.1 të Ligjit Nr. 03/L-146 për tatimin mbi vlerën e shtuar përcaktohet që TVSh ngarkohet me normën prej 16 %, ligj ky i cili ka qenë në fuqi në momentin e nënshkrimit të kontratës. Ndërsa, me datë 01.09.2015 ka hyrë në fuqi ligji i ri mbi vlerën e shtuar, duke ndryshuar normën e interesit nga 16% në normën e interesit në 18%. Me tej, ka theksuar se sipas ndryshimeve, pasi që çmimi kontraktues ka qenë në shumë prej EUR 394,367.00, përkatësisht me tatim prej 16% del të jetë si vlerë e tatimit shuma prej EUR 63,098.72, ndërsa me 18% si vlerë e tatimit shuma prej EUR 70,986.06, ashtu që ndryshimi i lartësisë së tatimit ka qenë në shumë prej 7,887.34 EUR, si detyrim për pagesë nga e paditura. Duke qenë se edhe me nenin 18.3 të kontratës është përcaktuar se *“menaxheri i kontratës do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve”*, ashtu që ka qenë përgjegjësi e të paditurës që të bëjë harmonizimin e çmimit të kontraktuar nëse ka ngritje të tatimeve. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

E paditura, në përgjigjen në padi të dorëzuar në gjykatë me datë 01.12.2020 si dhe seancën përgatitore e ka kontestuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit me arsyetimin se pretendimet se e paditura është përgjegjëse për rimbursim të TVSh-së si pasojë e ndryshimit të ligjit janë të pa bazuara, pasi që paditësi nuk ka fakte me të cilat provon së dëmi i pretenduar për shkak të ngritjes së TVSh-së është shkaktuar me fajin e të paditurës. Tutje, ka theksuar se bazuar në nenin 2.2 të aneks kontratës së datës 11.03.2015 theksohet se çmimi total i punëve që do të kryhen do të jetë shuma prej EUR 394,367.00 dhe do të jetë e vetmja pagesë sipas kontratës. Ka theksuar se

kontrata mes palëve është nënshkruar me datë 11.03.2015, e ku sipas së njëjtës është paraparë që punimet të fillojnë tre (3) ditë pas nënshkrimit të kontratës, pra me datë 15.03.2015, dhe të zgjasin brenda 120 ditëve, respektivisht me datë 15.07.2015, ndërsa Ligji i ri për tatim mbi vlerën e shtuar ka hyrë në fuqi me datë 01.09.2015, që do të thotë pasi janë kryer punimet, ashtu që sipas nenit 18.4 të kontratës është përcaktuar që menaxheri i projektit nuk do të lejoj ndryshimin e çmimit kontraktual për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes së detyrimeve doganore, nëse kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qenë në vonesë kontraktuesi. Tutje, ka shtuar se paditësi me datë 22.10.2018 ka paraqitur kërkesë për harmonizim të TVSh-së, mirëpo në rastin konkret kërkesa për rimbursim ka arritur parashkrimin, sipas nenit 355 të LMD-së pasi që nga data e hyrjes në fuqi të ligjit të ri e deri të data e dërgimit të parashtrësës kanë kaluar më shumë se tre (3) vite. Andaj, i ka propozuar gjykatës që të refuzojë në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pa bazuar, ndërsa të obligohet paditësi që të paguajë shpenzimet e procedurës.

Në seancat e mbajtura, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka qëndruar në tërësi pranë kërkesëpadisë, duke shtuar se përgjegjësia e vonesave të punimeve nuk ka qenë për shkak të paditësit, mirëpo me fajin ekskluziv të paditurës sepse e njëjta pavarësisht faktit të nënshkrimit të kontratës për shumën prej EUR 394,367.64, në linjat e saj buxhetore ka kufizuar shumat sikurse në njoftimin e vitit 2017 me nr. DKA-482/17 të datës 09.03.2017, sipas të cilit paditësi është detyruar që të kryejë punimet vetëm deri në vlerën prej EUR 60,000.00, ndërsa punimet e pa përfunduara nga kontrata për shkak të mungesës së buxhetit të realizohen gjatë vitit 2018. Në këtë drejtim, pretendimi i të paditurës se ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimeve kontraktore është i pa bazuar, pasi që e paditura me veprimet e saj, përkatësisht me njoftime drejtuar paditësit për shkak të mungesës së buxhetit ka shtyrë për disa vite përmbushjen e tërësishme të detyrimit që ka rrjedh nga kontrata, ashtu siç përcaktohet me nenin 306, par. 1 të LMD-së. Më tej, ka theksuar se sa i përket pretendimit të paditurës për parashkrim, nisur nga fakti se fatura e parë është e vitit 2015, kurse ajo e fundit 2019, ndërsa padia është paraqitur me datë 23.07.2019, e njëjta ka aluduar se ka arritur parashkrimi 3 vjeçar, mirëpo paditësi të gjitha faturat i ka lëshuar sipas legjislacionit në fuqi me lartësinë e TVSh-së prej 18%, kurse e paditura faturat e njëjta i ka pagur me lartësi prej 16% të TVSh-së, andaj edhe paditësi ka qenë i detyruar që të paguajë vetë diferencën e TVSh-së, ashtu që sipas nenit 253, par. 2 i LPK-së, lidhur me nenin 194 të LMD-së është pasuruar pa bazë juridike, e që për këtë kërkesë vlen afati 5 vjeçar i parashkrimit. E për me tepër pasi që objekti i kërkesëpadisë është rimbursimi i TVSh-së sipas Ligjit të vjetër për Administrimin e Tatimeve dhe Procedurave, me nenin 30 par. 3, kërkesa për rimbursimin e TVSH-së parashkruhet për 6 vite.

Ndërsa, pas pranimit të ekspertizës financiare i autorizuari i paditësit përmes parashtrësës së datës 26.11.2024, ka bërë precizimin e kërkesëpadisë duke kërkuar nga gjykata që të aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë diferencën e tatimit në shumë prej EUR 7,887.34, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 23.07.2019 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej EUR 778.40.

E paditura në seancën përgatitore ka theksuar se mbetet në tërësi pranë përgjigjes në padi pasi që kërkesa për rimbursimin e TVSH-së është e pa bazuar, ngase nga kontrata e lidhur ndërmjet paditësit dhe të paditurës e datës 11.03.2015, e ku në kushtet e veçanta të kësaj kontrate është paraparë që punimet të fillojnë 3 ditë pas nënshkrimit të saj dhe plani dinamik për ekzekutimin e punëve është 120 ditë, respektivisht me datë 15.07.2015. Ndërsa, ndryshimi i vlerës në tatim nga 16% në 18% ka ndodhur me datë 01.09.2015 me hyrjen në fuqi të Ligjit për tatim, që nënkupton pasi që ka qenë e planifikuar të kryhen punimet. Ka shtuar se edhe me nenin 18, par. 4 të kontratës është përcaktuar që nuk do të lejohet ndryshimi i çmimit për shkak të ngritjes së tatimit nëse kjo ka ndodhur me fajin e kontraktuesit. Tutje, ka theksuar se kemi të bëjmë me parashkrim sipas nenit 355 të LMD-së, ku kërkesat reciproke nga kontrata komerciale parashkruhen në afat prej 3 vitesh. I ka propozuar gjykatës që të refuzojë kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin kryesor të datës 23.01.2025, në të cilin ka prezantuar përfaqësuesi i autorizuar i paditësit, ndërsa e paditura edhe pse ka qenë e ftuar në mënyrë të rregullt për seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.01.2025, e njëjta nuk ka prezantuar në seancë dhe mungesën nuk e ka arsyetuar. Andaj, Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 423.4 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), shqyrtimin kryesor e ka mbajtur në mungesë të palës së paditur.

Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare, përfaqësuesi i autorizuar i paditësit ka theksuar se lartësia e kërkesëpadisë është vërtetuar përmes ekspertizës së datës 18.11.2024, përmes së cilës është konstatuar se diferenca e tatimit mbi vlerën e shtuar nga norma e interesit prej 16% në normën e interesit në 18 % sipas lartësisë së kontratës është shuma prej EUR 7,887.34. Për këto arsye, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa të detyrohet e paditura që paditësit t'ia paguajë diferencën e tatimit në shumë prej EUR 7,887.34, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 23.07.2019 e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën

kërcënimin e përmbartimit të dhunshëm. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë në emër të përpilimit të padisë në shumë prej EUR 104.00, për përpilimin e precizimit të padisë në shumë prej EUR 104.00, për përfaqësim në dy seanca gjyqësore, nga EUR 135.20 për secilën seancë, në shumë të përgjithshme prej EUR 270.40, për ekspertizë financiare shumë prej EUR 300.00, në shumë të përgjithshme prej EUR 778.40.

Gjykata, pasi që parashtresën me precizim të kërkesëpadisë ia ka dorëzuar palës së paditur me qëllim të dhënies së mundësisë për tu deklaruar e cila parashtresën në fjalë e ka pranuar me datë 05.12.2024 dhe mirëpo që nuk është deklaruar dhe në seancë të shqyrtimit kryesor nuk ka prezantuar, përmes aktvendimit procedural ka lejuar precizimin e kërkesëpadisë në aspektin objektiv të paraqitur nga përfaqësuesi i autorizuar i paditësit sikurse në parashtresën e datës 26.11.2024, duke vlerësuar se janë plotësuar kushtet nga neni 258.4 të LPK-së.

Provat e administruara dhe gjendja faktike e vërtetuar:

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor bëri administrimin e provave si në vijim: Kontrata me numër të prokurimit 622-14-152-521 e datës 11.03.2015 së bashku me kushtet e përgjithshme; Interpretimi ligjor mbi ndikimin e ndryshimit të Ligjit mbi TVSH-në tek kontratat efektive para hyrjes në fuqi të këtij ligji nr. 135/15 të datës 11.09.2015; Kërkesa e paditësit drejtuar të paditurës për harmonizimin e TVSh-së me nr. të protokollit nr.1079/19; Fatura nr. 21/15 e datës 21.09.2015; Fatura nr. 04/19 e datës 04.04.19; Fatura nr. 02/16 e datës 06.04.2016; Fatura nr. 05/17 e datës 27.07.2017; Fatura nr. 06/17 e datës 27.07.2017; Fatura nr. 08/18 e datës 13.09.2017; Fatura nr. 1/18 e datës 20.03.2018; Fatura nr. 02/18 e datës 02.05.2018; Fatura nr. 04/18 e datës 08.06.2018; Fatura nr. 07/18 e datës 07.08.2018; Fatura nr. 12/18 e datës 22.10.2018; Fatura nr. 13/18 e datës 09.11.2018; Fatura nr. 05/19 e datës 25.04.2019; Fatura nr. 06/19 e datës 15.07.2019; Fatura nr. 06/16 e datës 14.06.2016; Fatura nr. 10/16 e datës 29.09.2016; Fatura nr. 03/19 e datës 04.04.2019; Njoftimi me nr. të protokollit nr. 482/17 i datës 09.03.2017; Ekspertiza financiare e datës 18.11.2024; Urdhërpagesa me nr. 2018-12257; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 01/2018 i datës 26.03.2018; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 21/0185 i datës 21.09.2015; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 02/2016 i datës 06.04.2016; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 06/016 i datës 15.06.2016; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 622-14-152-521 i datës 29.09.2016; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 05/2017 i datës 31.07.2017; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 06/2017 i datës 31.07.2017; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 08/2017 i datës 26.09.2017; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 06/2019 i datës 19.07.2019; Procesverbal për pranim

teknik i datës 19.07.2019; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 02/18 i datës 03.05.2018; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 04/18 i datës 08.06.2018; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 07/2018 i datës 10.08.2018; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 12/2018 i datës 23.10.2018; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 13/2018 i datës 15.11.2018; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 03/2019 i datës 10.04.2019; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 05/2019 i datës 15.04.2019; Procesverbal mbi realizimin e punimeve nr. 13/2018 i datës 15.11.2018.

Deklarimet e palëve ndërgjyqëse, si dhe provat tjera të prezantuara dhe të administruara, gjykata i vlerësoi të gjitha një nga një dhe në varësi me njëra tjetrën, në vështrim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe gjeti se:

Në rastin konkret nuk është kontestuese se palët ndërgjyqëse, respektivisht Komuna e Prizrenit në cilësinë e Autoritetit Kontraktues dhe NN “Shqipëroni” në cilësinë e punë kryerësit, me datë 11.03.2015 kanë lidhur kontratën për ndërtimin e objektit të ri shkollor (9 klasa) “Ekrem Rexha” në Gërnqarë të Prizrenit, për çmimin në shumë prej EUR 394,367.00. Kjo kontratë përmban nënshkrimin e menaxherit J.M për punë kryerësin dhe UD i Menaxherit të Prokurimit për Autoritetin Kontraktues.

Nga shkresa e datës 14.09.2015, rezulton se Bordi i KRPP-së, ka ofruar interpretimi ligjor mbi ndikimin e ndryshimit të Ligjit mbi TVSH-në tek kontratat efektive para hyrjes në fuqi të Ligjit nr. 135/15 të datës 11.09.2015, ku sipas këtij bordi autoritetet kontraktues duhet të rregullojnë kontratat në harmoni me detyrimet tatimore në pajtim me Ligjin për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, me përjashtim të rasteve kur kontraktuesi është në vonesë.

Nga shkresa me numër të protokollit 1079/19, Gjykata ka konstatuar faktin se paditësi me datë 19.04.2019 i është drejtuar të paditurës me kërkesë për e harmonizimin e TVSh-së, ngase kontrata mes palëve është lidhur me datë 11.03.2015, ndërsa Ligji mbi Tatimin për vlerën e shtuar ka hyrë në fuqi me datë 01.06.2015, ku ka ndryshuar TVSH në 18%, ashtu që vlera e TVSh-së.

Nga Njoftimi me numër të protokollit 482/17, i datës 09.03.2017, Gjykata ka vërtetuar faktin se Komuna e Prizrenit, si autoritet kontraktues, ka njoftuar paditësin si operator ekonomik se në kuadër të planifikimit të investimeve kapitale për vitin 2017 është planifikuar shuma prej EUR 60,000.00 dhe se punimet duhet të realizohen sipas këtij buxheti, ndërsa punimet e pa

përfunduara nga kontrata e lidhur mes këtu palëve ndërgjyqëse, për shkak të mungesës së buxhetit, do të realizohen gjatë vitit kalendarik 2018.

Nga faturat e administruara si prova në këtë procedurë, rezulton se paditësi ka kryer shërbime sipas kontratës së lidhur mes ndërgjyqësve dhe kërkesave të të paditurës dhe se të njejtat i ka dorëzuar pranë të paditurës me qëllim të inkasimit të pagesave sipas punëve të realizuara. Ndërsa, në secilën faturë paditësi ka deklaruar tatimin mbi vlerën e shtuar në normë të interesit në lartësi prej 18%, në përputhje me Ligjin nr.05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar.

Nga procesverbalet mbi realizimin e punimeve në ndërtimin e objektit të ri shkollor në Gërnqarë, të administruara si prova në këtë procedurë, Gjykata ka vërtetuar faktin se paditësi ka realizuar punimet sipas kontratës nr. 622-14-152-521, të datës 11.03.2015, dhe se komisioni në përbërje prej tre anëtarësh i formuar në kuadër të të paditurës, ka konstatuar se operatori ekonomik N.N “Shqipëroni”, këtu paditësi ka realizuar punimet në nivel të kënaqshëm sipas kontratës, duke rekomanduar që pagesat ti bëhen paditësit sipas faturave të dorëzuara.

Ndërsa, nga procesverbali për pranim teknik i datës 19.07.2019, vërtetohet fakti se komisioni i formuar nga ana e të paditurës në përbërje prej tre anëtarësh, me datë 12.07.2019 ka dal në teren dhe nën pranim kryesit të punës, këtu paditësit, ka konstatuar se të gjitha punimet sipas kontratës nr. 622-14-125-521, në vlerë prej EUR 394,367,00, janë realizuar sipas kontratës dhe në nivel të kënaqshëm, ku janë kryer poashtu edhe punime plotësuese për të cilat është njoftuar nga ana e punë kryesit, duke rekomanduar që punimet të pranohen teknikisht dhe të realizohet pagesa përfundimtare sipas pozicioneve të faturës.

Gjykata, me propozimin e palës paditëse, ka bërë marrjen e provës përmes ekspertizës nga lëmia financiare. Nga Ekspertiza financiare e datës 18.11.2024, e punuar nga ekspertja financiare Mihrie Morina Mustafa është konstatuar se diferenca e tatimit mbi vlerën e shtuar nga norma e interesit 16 % në normën e interesit 18% sipas lartësisë së kontratës së datës 11.03.2015 në shumë totale prej EUR 394,367.00, është EUR 7,887.34. Ndërsa, në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 23.01.2025, ekspertja financiare ka qëndruar në tërësi pranë ekspertizës duke theksuar se për shumën prej EUR 394,367.00, nëse llogaritet me normën prej 18%, rezulton të jetë shuma prej EUR 70,986.00, ndërsa nëse aplikohet norma prej 16% është shuma prej EUR 63,098.72, ashtu që diferenca në mes të këtyre vlerave është shuma prej EUR 7,887.34.

Baza juridike e kërkesëpadisë:

Referuar raportit të krijuar mes palëve ndërgjyqëse, Gjykata gjeti se në rastin konkret gjejnë zbatim dispozitat e Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve (tutje referuar si LMD).

Sipas nenit 4.1 të LMD-së përcaktohet se *“Në krijimin e marrëdhënieve të detyrimeve dhe në ushtrimin e të drejtave dhe përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga këto marrëdhënie, pjesëmarrësit duhet t’i përmbahen parimit të ndërgjegjshmërisë dhe ndershmërisë.”*. Ndërsa, me nenin 8.1 të të njëjtit nen përcaktohet se *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e të njëjtit.”*

Në anën tjetër, me nenin 245.1 të LMD-së, është përcaktuar se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e ti.”*

Vlerësimet e gjykatës:

Nga provat administruara si dhe deklaramet e palëve ndërgjyqëse, rezulton se mes paditësit në cilësi të operatorit ekonomik dhe të paditurës si autoritet kontraktues, me datë 11.03.2015, është lidhur kontrata për ndërtimin e objektit shkollor (9 klasa) “Ekrem Rexha” në Gërnqarë të Prizrenit, me një çmim kontraktues prej 394,637.00 EUR. Sipas nenit 18.3 të kontratës është përcaktuar se *“menaxheri i projektit do të harmonizoj çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve.”*

Në momentin e lidhjes së kësaj kontrate lartësia e tatimit mbi vlerën e shtuar sipas Ligjit Nr. 03/L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, ishte 16%. Ndërsa, ndërmjet datës së lidhjes së kontratës 11.03.2015 dhe datës 12.07.2019 për përfundimin e punimeve sipas kontratës, përkatësisht me datë 01.09.2015, ka hyrë në fuqi ligji i ri nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar i cili ka ndryshuar normën e TVSh-së nga 16% në 18%. Si rezultat i kësaj, tatimi i aplikueshëm për çmimin total të punimeve të kontraktuar në vlerë prej EUR 394,367.00 është rritur nga shuma EUR 63,098.72 e cila përbën normën e interesit 16%, në shumën EUR 70,986.06 sipas normës së interesit prej 18%, duke krijuar kështu një diferencë prej EUR 7,887.34 të paguar më tepër nga ana e paditësit në emër të diferencës së tatimit mbi vlerën e shtuar.

Ndërsa, e paditura edhe përkundër që sipas nenit 18.3 të kontratës me të cilin përcaktohet se *“Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të përfundimit të punëve”*, ka pasur për detyrë të bëjë harmonizimin e çmimit të kontraktuar në proporcion me vlerën e rritur të lartësisë së TVSh-së, sipas Ligjit nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar, nuk ka vepruar.

Nisur nga kjo gjendje, përkatësisht refuzimi i të paditurës për harmonizimin e çmimit të kontraktuar në proporcion me normën e rritur të TVSh në lartësi prej 18%, paditësit i ka shkaktuar humbje financiare pasi që i njëjti të gjitha faturat e lëshuara në emër të punimeve të kryera sipas kontratës së lidhur me të paditurën i ka deklaruar me normë të TVSh-së prej 18%.

Andaj, duke qenë se e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e saj kontraktual, përkatësisht nuk ka harmonizuar çmimin e kontratës së ndërgjyqësve në proporcion me vlerën e rritur të lartësisë së TVSh-së, rezulton se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar në nenin 245 të LMD-së, i cili përcakton se *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e ti”*, pasi që mes palëve është krijuar raporti detyrimor ku paditësi ka cilësinë e kreditorit, ndërsa e paditura cilësinë e debitorit dhe rrjedhimisht Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke e aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Ndërsa, lartësinë e kërkesëpadiës gjykata e mbështeti në ekspertizën financiare të datës 18.11.2024, në të cilën ekspertizë eksperti financiar ka konstatuar se diferenca e tatimit mbi vlerën e shtuar nga norma e interesit 16% në normën e interesit 18% sipas lartësisë së kontratës së datës 11.03.2015 në shumën totale prej EUR 394,367.00, është në vlerë prej EUR 7,887.34. Kësaj ekspertize gjykata ia fali në tërësi besim në raport me përcaktimin e lartësisë së kërkesëpadiës, pasi që e njëjta është punuar në mënyrë profesionale, brenda vëllimit të përcaktuar nga gjykata, si dhe e njëjta gjen mbështetje edhe në provat e tjera të cilat gjenden në shkresa të lëndës.

Përgjatë vendosjes në këtë çështje kontestimore, Gjykata pati parasysh pretendimet e të paditurës e cila ka pretenduar se kontraktuesi është vonuar në kryerjen e punimeve dhe për rrjedhojë nuk i takon e drejta për të kërkuar harmonizimin e çmimit për shkak të ngritjes së normës së TVSh-së, mirëpo të njëjtat i gjeti të pabazuara nga fakti se me provat e administruara si procesverbalet

mbi realizimin e punimeve në ndërtimin e objektit ri shkollor në Gërnqarë, e në veçanti nga procesverbali mbi pranimin teknik të punimeve, i datës 19.07.2019, ka rezultuar se paditësi i ka realizuar të gjitha punimet sipas kontratës të cilat punime janë pranuar teknikisht nga komisioni i të paditurës dhe pa vërejtje, duke rekomanduar edhe kryerjen e pagesave për punimet e realizuara konform kontratës. Përveç kësaj, nga njoftimi me numër 482/17, i datës 09.03.2017, i lëshuar nga vet e paditura ka rezultuar se vonesat në realizimin e kontratës kanë qenë si rezultat i pamjaftueshmërisë së buxhetit të të paditurës, e cila e ka njoftuar paditësin që për vitin 2017 në emër të kontratës 622-14-152-521 të lidhur mes palëve ndërgjyqëse janë planifikuar buxhet EUR 60,000.00, duke e udhëzuar paditësit që të kryej punime vetëm deri në këtë vlerë, ndërsa për punimet e tjera të papërfunduara nga kjo kontratë, për shkak të mungesës së buxhetit, janë planifikuar të realizohen në vitin 2018.

Sikundër, Gjykata i gjeti të pabazuara edhe pretendimet për parashkrim të kërkesës së paditësit në kuptim të nenit 355 të LMD-së. Në raport me këto pretendime, fillimisht Gjykata sqaron se afati tre (3) vjeçar i përcaktuar në nenin 355 të LMD-së, nuk gjen zbatim në këtë kontest, pasi që kjo dispozitë aplikohet në kërkesat të cilat burojnë nga kontratat komerciale, kontrata këto të cilat sipas nenit 12.2 të LMD-së, konsiderohen vetëm ato kontrata të lidhura nga subjektet komerciale ndërmjet tyre.

Në rastin konkret, kontrata objekt shqyrtimi është kontratë e lidhur sipas Ligjit për prokurimin publik, mes të paditurës në cilësi të autoritetit kontraktues si person juridik publik dhe operatorit ekonomike si shoqëri tregtare e organizuar në formë të biznesit individual, dhe rrjedhimisht nuk mund të trajtohet si kontratë komerciale mes entiteteve afariste që kryejnë veprimtari fitimprurëse, në kuptim të nenit 12, paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së. Në anën tjetër, përderisa me dispozitat e LMD-së nuk është përcaktuar afati i veçantë i parashkrimit, atëherë për trajtimin e afatit të parashkrimit në këtë kontest mes palëve ndërgjyqëse zbatim gjen dispozita nga neni 352 i LMD-së, sipas së cilës dispozitë *“Kërkesat parashkruhen për pesë (5) vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit”*.

Andaj, duke vlerësuar afatin e përgjithshëm të parashkrimit sipas nenit 352 të LMD-së, rezulton se kërkesa e paditësit për kompensimin e diferencës së tatimit mbi vlerën e shtuar nga norma e interesit 16% në normën e interesit 18%, nuk është përfshi në parashkrim pasi që nga momenti kur paditësi i ka lindur e drejta, data 01.09.2015 datë kjo kur Ligji nr. 05/L-037 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar ka hyrë në fuqi, e deri në datën e paraqitjes së padisë nga ana e paditësit në Gjykatë, datë 23.07.2019, nuk kanë kaluar pesë (5) vite.

Vendimi mbi kamatën ligjore dhe shpenzimet e procedurës:

Vendimin mbi kamatën gjykata e mbështeti duke iu referuar nenit 382 të LMD-së, me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, ashtu që ka detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguajë edhe kamatën ligjore prej 8 % në vit mbi shumën e gjykuar si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit, duke filluar nga data e paraqitjes së padisë, data 23.07.2019 e deri në pagesën definitive.

Ndërsa, vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 452.1 të LPK-së. Në rastin konkret shpenzimet e krijuara gjyqësore si detyrim i paditësit, i referohen shumës së precizuar si në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit, e cila përfshin shpenzimet procedurale të kërkuara dhe të provuara nga të paditurit, dhe atë shpenzimet në emër të përpilimit të padisë në shumën prej EUR 104.00, në emër të seancave të mbajtura nga EUR 135.20 për secilën seancë, apo për dy seanca të mbajtura shumën prej EUR 270.40, në emër të ekspertizës financiare shumën prej EUR 300.00, apo shpenzimet e procedurës në shumë të përgjithshme prej EUR 674.40.

Ndërsa, shpenzimet e kërkuar në emër të parashtresës për precizim të kërkesëpadisë në shumë prej EUR 104.00, Gjykata nuk ia njohu paditësit nga fakti se parashtresa e dorëzuar në Gjykatë për precizimin e kërkesëpadisë nga ana e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, nuk paraqet shpenzim të domosdoshëm procedural në kuptim të nenit 453.1 të LPK-së.

Nga sa më sipër, në bazë të nenit 143 të LPK-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KE.nr. 380/22, datë 31.01.2025

Gjyqtari
Arbër Rexha

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.